



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVO
GJYKATA E APELIT PRISHTINË

Numri i lëndës: 2019:267791
Datë: 11.07.2024
Numri i dokumentit: 05925661

AA.nr.449/2024

GJYKATA E APELIT E KOSOVËS - Departamenti për Çështje Administrative, në kolegjin e përbërë nga gjyqtarët: Ramiz Kuqi kryetar, Delushe Halimi dhe Hajriz Hoti anëtarë, me bashkëpunëtoren profesionale Hajrije Krasniqi, në konfliktin administrativ sipas padisë së paditëses A.V nga Graçanica, të cilën e përfaqëson përfaqësuesi ligjor-prindi S.V, kundër të paditurës Ministria e Punës dhe e Mirëqenies Sociale-Departamenti i Pensioneve, me bazë juridike anulim i vendimit me nr.6761 të datës 18.04.2019, me kërkesë për pagesën e kompensimit për personat Paraplegjik dhe Tetraplegjik nga grupi i parë, duke vendosur sipas ankesës së të paditurës, paraqitur kundër aktgjykimit të Gjykatës Themelore në Prishtinë - Departamenti për Çështje Administrative, A.nr.1836/2019 të datës 16.01.2024, në seancën e kolegjit të mbajtur me datë 08.07.2024, mori këtë:

A K T G J Y K I M

Refuzohet si e pa bazuar ankesa e të paditurës, Ministria e Financave, Punës dhe Transfereve – Departamenti i Administratës Pensionale në Prishtinë, ndërsa aktgjykimi i Gjykatës Themelore në Prishtinë - Departamenti për Çështje Administrative, A.nr.1836/2019 i datës 16.01.2024, **vërtetohet**.

A r s y e t i m

Me aktgjykimin e Gjykatës Themelore në Prishtinë - Departamenti për Çështje Administrative A.nr.1836/2019 të datës 16.01.2024, në pikën I të dispozitivit është aprovuar në tersi si e bazuar kërkesëpadia e paditëses A.V nga Graçanica, të cilën e përfaqëson përfaqësuesi

ligjor-prindi S.V. Në pikën II të dispozitivit të aktgjykimit është anuluar vendimi me nr. të dosjes 6761 i datës 01.03.2019 dhe ai i datës 13.05.2019 i Ministrisë së Punës dhe Mirëqenies Sociale-Departamenti i Pensioneve dhe paditëses A.V nga Graçanica i njihet e drejta në kompensim për personat Paraplegjik dhe Tetraplegjik nga grupi i parë nga data 12.12.2018. Në pikën III të dispozitivit të aktgjykimit është obliguar e paditura Ministria e Financave, Punës dhe Transfereve, që paditëses A.V nga Graçanica, t'ia paguaj në mënyrë retroaktive diferencën e kompensimit për personat Paraplegjik dhe Tetraplegjik në mes të grupit të dytë dhe të parë nga data 12.12.2018 e deri me 16.01.2023, për 62 muaj gjithsej në shumën e përgjithshme prej 13,950.00€, në afat prej 15 ditësh nga dita e marrjes së këtij aktgjykimi. Në pikën IV të dispozitivit të aktgjykimit paditëses A.V nga Graçanica i njihet e drejta në kompensim për personat Paraplegjik dhe Tetraplegjik nga data 07.12.2023 për periudhë pesë vjeçare, respektivisht deri me datë 06.12.2028, derisa të ekzistojnë kushtet ligjore. Në pikën V të dispozitivit të aktgjykimit është vendosur që ky aktgjykim e zëvendëson vendimin me nr. të dosjes 6761 të datës 01.03.2019 dhe atë të datës 13.05.2019 të Ministrisë së Punës dhe Mirëqenies Sociale-Departamenti i Pensioneve. Në pikën IV të dispozitivit të aktgjykimit është vendosur që secila palë i bart shpenzimet e veta procedurale.

Kundër këtij aktgjykimi në afat ligjor ka parashtruar ankesë e paditura Ministria e Financave, Punës dhe Transfereve – Departamenti i Administratës Pensionale në Prishtinë përmes përfaqësueses të autorizuar, Ministria e Drejtësisë - Avokatura Shtetërore, për shkak të: shkeljes esenciale të dispozitave të procedurës, vërtetimit të gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike dhe zbatimit të gabuar të së drejtës materiale. Me propozim që të aprovohet si e bazuar ankesa e të paditurës dhe aktgjykimi i ankimuar të prishet ashtu që të mbetet në fuqi vendimi me nr. të dosjes 6761 i datës 01.03.2019.

Gjykata e Apelit, shqyrtoi shkresat e lëndës, aktgjykimin e ankimuar, pretendimet ankimore në ankesë, dhe pas vlerësimit të tyre në kuptim të nenit 49 par.1 të Ligjit për Konfliktet Administrative (LKA), lidhur me nenin 194 të Ligjit për Procedurën Kontestimore (LPK), të aplikueshëm sipas nenit 63 të LKA-së, gjeti se:

Ankesa është e pa bazuar.

Nga shkresat e lëndës rezulton se e paditura Ministria e Punës dhe Mirëqenies Sociale – Departamenti i Pensioneve në Prishtinë, me vendimin e kontestuar me nr. të dosjes 6761 të datës 13.05.2019, Ministria e Punës dhe Mirëqenies Sociale-Departamenti i Pensioneve, ka refuzuar si të pabazuar ankesën e paditëses për njohjen e së drejtës në kompensim për personat Paraplegjik dhe Tetraplegjik të grupit të parë, duke lënë në fuqi vendimin me nr. 6761 të datës 01.03.2019, me të cilin paditëses i është miratuar kërkesa për kompensim për personat Paraplegjik dhe Tetraplegjik të Grupit të Dytë prej datës 12.12.2018, në shumë mujore prej 150€, për tri vite.

Paditësja e pakënaqur me vendimin e lartcekur të paditurës Ministria e Punës dhe Mirëqenies Sociale – Departamenti i Pensioneve në Prishtinë, ka ushtruar padi për konflikt administrativ me datën 01.08.2019, me pretendim se i njëjti është i pa drejtë dhe që të ndryshohet vendimi i shkallës së parë në paragrafin 1 në lidhje me shumën e pranuar të kompensimit.

Gjykata e shkallës së parë pas shqyrtimit të padisë së paditëses të paraqitur kundër vendimit të lartcekur të paditurës Ministria e Punës dhe Mirëqenies Sociale – Departamenti i Pensioneve në Prishtinë, dhe pas administrimit të provave si në procesverbal të shqyrtimit kryesor, e duke u bazuar edhe në provat dhe dëshmitë e tjera të lëndës bie aktgjykimin e ankimuar me të cilin kërkesëpadinë e paditëses e aprovon si të bazuar, duke vendosur sikurse në dispozitiv të aktgjykimit të ankimuar. Me arsyetim se me qëllim të vërtetimit të drejt dhe të plotë të gjendjes faktike në këtë konflikt administrativ, përkatësisht se cilit grup të personave Paraplegjik dhe Tetraplegjik i takon paditësja, gjykata e shkallës së parë në seancën gjyqësore të datës 01.11.2023, sipas propozimit të përfaqësuesit ligjor të paditëses ka caktuar nxjerrjen e provës me ekspertizë mjekësore në përbërje prej të mjekësve specialist dhe atë Dr.E.K-Neurolog, Dr.F.G-Fiziatër dhe Dr.M.O-Urolog. Komisioni mjekësor në përbërje prej mjekësve specialist pas ekzaminimit të drejtpërdrejt të paditëses dhe analizimit të dokumentacionit mjekësor në shkresat e lëndës, kanë përpiluar raportin e ekspertizës mjekësore të datës 07.12.2023, ku kanë dhënë mendimin profesional se paditësja A.V është persona me aftësi të kufizuar me pasoja të përhershme dhe e pa aftë për tu kujdesur për vetveten, për lëvizje, ushqim, higjienë personale, me inkontinenc permanente, mbrojtje antidekubitare dhe nevojë për terapi fizikale për ti parandaluar komplikimet e tjera, andaj me këtë veçori ekspertin mjekësor kanë vlerësuar se paditësja i takon grupit të parë sipas Ligjit për personat Paraplegjik dhe Tetraplegjik. Në seancën e shqyrtimit kryesor të datës 05.09.2023 ekspertët mjekësor të pranishëm në seancë Dr.M.O-Urolog dhe Dr.E.K-Neurolog, kanë deklaruar mbetemi pranë ekspertizës mjekësore e cila i është

dorëzuar gjykatës. Sipas ekspertëve meqenëse lindja e paditëses ka qenë lindje e parakohshme dhe me probleme, në bazë të dokumentacionit mjekësor, pastaj kanë filluar ekzaminimet në fëmijëri të hershme dhe aty janë vërejtur dëmtimet të cilat i ka në kokë dhe të cilat pastaj janë prezantuar me probleme edhe në zhvillimin motorik dhe në pjesën psikike, respektivisht në ngecje psikomotorike dhe këto probleme janë të natyrës së përhershme dhe me tendencë të përkeqësimit me kalimin e viteve dhe se paditësja është person me inkontinenc. Pas analizimit dhe vlerësimit të provave të cilat gjenden në shkresat e lëndës, gjykata e shkallës së parë erdhi në përfundim se kërkesëpadia e paditëses është e bazuar në ligj dhe fakte. Nga provat e administruara gjatë kësaj procedure të konfliktit administrativ e sidomos nga ekspertiza mjekësore e datës 07.12.2023 e mjekësve specialist Dr.E.K-Neurolog, Dr.F.G-Fiziatër dhe Dr.M.O-Urolog, të cilës gjykata ja fali besimin në tërësi, sepse e njëjta ishte profesionale, e argumentuar mirë sipas vëllimit të përcaktuar për vërtetimin e fakteve vendimtare me rëndësi në këtë konflikt administrativ, si dhe bazuar në dokumentacionin mjekësor për paditësen i cili gjendet në shkresat e lëndës dhe Raportet Konziliare për përcjellës për paditësen të datës 29.11.2023 dhe dt.10.03.2023, gjykata erdh në përfundim se në rastin konkret paditësja i plotëson kushtet ligjore nga neni 1 par.1 pika 1.1 dhe 1.2, dhe neni 7 dhe 8 të Ligjit nr.05/L-067 për Statusin dhe të Drejtat e Personave Paraplegjik dhe Tetraplegjik, si dhe neni 5 par. 1 pika 1.3 dhe 1.4 të Rregullores nr.07/2017 për Përbërjen, Funkcionimin, Përgjegjësitë e Komisionit Vlerësues dhe Përcaktimin e Procedurave për Njohjen e Statusit dhe të Drejtave të Personave Paraplegjik dhe Tetraplegjik, për të qenë përfitues i kompensimit për personat Paraplegjik dhe Tetraplegjik nga grupi i parë nga data 12.12.2018, kur e paditura paditëses i ka miratuar kërkesën për kompensim për personat Paraplegjik dhe Tetraplegjik të grupit të dytë. Kjo ngase siç kanë konstatuar ekspertët mjekësor në ekspertizë mjekësore dhe në seancën e shqyrtimit kryesor paditësja që ka lindje ka pasur probleme duke filluar nga lindja para kohe, me dëmtime të evidentuara të trurit e të cilat kanë pasur ndikim në ngecjen psikofizike të saj. Ajo ka qenë e hospitalizuar në Beograd fillimisht për diagnostifikim në vitin 1995 e pastaj në vitin 1999 për disa muaj, për trajtim rehabilitues. Si pasojë e dëmtimeve të trurit paditësja nuk ka arritur asnjëherë zhvillim normal motorik, ka dobësim të forcës muskulare në duar dhe sidomos në këmbë e që ka bërë që ajo të jetë e lidhur për karrocë me rrota. Ekspertët mjekësorë kanë konstatuar se nga aspekti i lëvizjes paditësja bën pjesë në grupin e personave Tetraplegjik (duart parazë kurse këmbët plegjike) që ja pa mundësojnë asaj kujdesin për nevojat bazike, nuk mund të ngritët nga karroca, nuk ecë nëse ngritët prej të tjerëve, nuk mund të ushqehet me duart e saj, nuk mund të vishet dhe mbathet apo të kujdeset për higjienën personale. Prandaj gjykata vendosi ta aprovoj kërkesëpadinë e paditëses si në dispozitiv të këtij aktgjykimi, ashtu që anuloi vendimet me nr. të dosjes 6761 i datës

01.03.2019 dhe të datës 13.05.2019 të Ministrisë së Punës dhe Mirëqenies Sociale-Departamenti i Pensioneve dhe që paditëses ti njihet e drejta në kompensim për personat Paraplegjik dhe Tetraplegjik nga grupi i parë nga data 12.12.2018, kurse në dispozitivin III të aktgjykimit, gjykata e shkallës së parë e detyroj të paditurën që paditëses, t'ia paguaj në mënyrë retroaktive diferencën e kompensimit për personat Paraplegjik dhe Tetraplegjik në mes të grupit të parë dhe të dytë, nga data 12.12.2018, kur e paditura ja ka njohur paditëses kërkesën për kompensim për personat Paraplegjik dhe Tetraplegjik të grupit të dytë me vendimin e datës 01.03.2019, e deri në muajin janar 2024, apo gjithsej për 62 muaj, në shumën e përgjithshme prej 13,950.00€, kurse në dispozitivin e IV gjykata e shkallës së parë vendosi që paditëses ti njihet e drejta në kompensim për personat Paraplegjik dhe Tetraplegjik nga data 07.12.2023 për periudhë pesë vjeçare, respektivisht deri me datë 06.12.2028.

Gjykata e shkallës së parë vlerëson se përfundimi dhe qëndrimi i të paditurës i dhënë në vendimin e kontestuar të shkallës së dytë të datës 13.05.2019 dhe në vendimin e organit të shkallës së parë të datës 01.03.2019, se paditësja i plotëson kushtet për kompensim për personat Paraplegjik dhe Tetraplegjik nga grupi i dytë, nuk është i drejt, për shkak se, në rastin konkret nuk është vepruar sipas rregullave të procedurës, nuk është vërtetuar drejt gjendja faktike dhe nuk janë aplikuar drejt dispozitat ligjore në fuqi, përkitazi me kushtet ligjore për njohjen e të drejtës në kompensim për personat Paraplegjik dhe Tetraplegjik. Kjo, sepse sipas vlerësimit të gjykatës se shkallës së parë e paditura kur i ka bërë vlerësim paditëses, përmes Komisionit Mjekësor i cili vepron në kuadër të paditurës, qoftë në vlerësimin në shkallë të parë me datë 22.02.2019, por edhe në vlerësimin në shkallë të dytë me datë 02.05.2019, nuk i është përmbajtur përgjegjësi të Komisionit Vlerësues të përcaktuara me nenin 5 të Rregullores nr.07/2017 për Përbërjen, Funkcionimin, Përgjegjësitë e Komisionit Vlerësues dhe Përcaktimin e Procedurave për Njohjen e Statusit dhe të Drejtave të Personave Paraplegjik dhe Tetraplegjik. Në këtë aspekt gjykata thekson se e Komisioni Mjekësor i të paditurës vlerësimin për paditësen nuk e ka kryer në mënyrë të plotë, ngase nuk dihet se cilin nga dokumentacioni mjekësor e ka shqyrtuar dhe analizuar për paditësen, nuk dihet nëse është ekzaminuar paditësja, pastaj nuk ka dhënë konstatimin lidhur me nevojën për edukim dhe arsimim të përhershëm për paditësen, nuk ka përcaktuar nëse paditësja ka nevojë për rehabilitim dhe për kujdestar personal, siç përcaktohet me nenin 5 par.1 pikat 1.1-1.7 të Rregullores nr.07/2017 për Përbërjen, Funkcionimin, Përgjegjësitë e Komisionit Vlerësues dhe Përcaktimin e Procedurave për Njohjen e Statusit dhe të Drejtave të Personave Paraplegjik dhe Tetraplegjik. Gjykata e shkallës së parë vlerëson se formulari vlerësues për njohjen dhe statusin dhe të drejtat e personave Paraplegjik dhe

Tetraplegjik i të paditurës, nuk është i hartuar konform Rregullores nr.07/2017 për Përbërjen, Funkcionimin, Përgjegjësitë e Komisionit Vlerësues dhe Përcaktimin e Procedurave për Njohjen e Statusit dhe të Drejtave të Personave Paraplegjik dhe Tetraplegjik, sepse siç shihet nga ku formular vendimmarrjen lidhur me njohjen ose jo të statusit dhe të drejtave të Personave Paraplegjik dhe Tetraplegjik e jep Komisioni Mjekësor, i cili sipas nuk e ka këtë kompetencë sipas Ligjit nr.05/L-067 për Statusin dhe të Drejtat e Personave Paraplegjik dhe Tetraplegjik dhe Rregullores nr.07/2017. Në rastin konkret komisioni mjekësor ka dhënë rezultatin e vendimit duke rrumbullakuar shenjen aprovim dhe grupi i dytë në formular, që gjë gjykata thekson se është në kundërshtim me kërkesat ligjore nga neni 5 par.1 pikat 1.2, 1.5, 1.6, 1.7 dhe neni 7 pika 6 dhe 7 e Rregullores nr.07/2017 për Përbërjen, Funkcionimin, Përgjegjësitë e Komisionit Vlerësues dhe Përcaktimin e Procedurave për Njohjen e Statusit dhe të Drejtave të Personave Paraplegjik dhe Tetraplegjik. Së këndejmi gjykata vë në theks se sipas paragrafit 6 dhe 7 të neni 7 të Rregullores nr.07/2017, Komisioni Vlerësues i shqyrton lëndën kurse Departamenti i Pensioneve pasi ta merr lëndën nga ky komision, merr vendim për njohjen apo mos njohjen e statusit për kompensim financiar për personin Paraplegjik dhe Tetraplegjik, bazuar në vlerësimin e Komisionit Vlerësues. Në vlerësimin e tërësishëm të çështjes, gjykata e shkallës së parë vlerëson se e paditësja i plotëson kushtet ligjore për të qenë përfitues i kompensimit nga grupi i parë i personave Paraplegjik dhe Tetraplegjik nga data 12.12.2018, për arsye se, e njëjta siç kanë konstatuar mjekët specialist të cilët e kanë kryer ekspertizën mjekësore për paditësen, paditësja në këtë rast i plotëson kushtet për të qenë përfitues i grupit të parë të personave Paraplegjik dhe Tetraplegjik. Gjukata thekson se e paditura nuk e ka kundërshtuar ekspertizën mjekësore të datës 07.12.2023, dhe nuk ka propozuar nxjerrjen e ndonjë ekspertize tjetër mjekësore e cila kishte me nxjerr konstatime tjera nga ekspertiza mjekësore. Duke u bazuar në gjendjen faktike të vërtetuar më lartë, gjykata e shkallës së parë përfundimisht cilëson se pretendimet e paditëses janë plotësisht të bazuara dhe të drejta dhe se e njëjta i plotëson kushtet ligjore për të qenë përfituese e kompensimit të personave Paraplegjik dhe Tetraplegjik nga grupi i parë sipas neni 7 dhe 8 të Ligjit nr.05/L-067 për Statusin dhe të Drejtat e Personave Paraplegjik dhe Tetraplegjik, nga data 12.12.2018, si dhe për të ardhmen nga data e ekspertizës mjekësore 07.12.2023 për periudhë 5 vjeçare, deri me datë 06.12.2028.

Qëndrimin juridik të gjykatës së shkallës së parë si të rregullt dhe të bazuar në ligj në tërësi e pranon edhe kjo gjykatë, për arsye se aktgjykimi i ankimuar nuk është përfshirë me shkelje qenësore të dispozitave të Ligjit për Konfliktet Administrative, të cilat shkelje gjykata e shkallës së dytë i heton sipas detyrës zyrtare, në bazë të neni 194 të Ligjit për Procedurën

Kontestimore, të aplikueshëm sipas nenit 63 të Ligjit për Konfliktet Administrative. Gjykata e shkallës së parë, duke vlerësuar ligjshmërinë e aktvendimit të kontestuar në kuptim të nenit 44 par.1 të Ligjit për Konfliktet Administrative, në drejtim të pretendimeve në padi, provave të administruara në seancë gjyqësore si dhe pas shqyrtimit të shkresave të tjera të lëndës, me të drejtë ka vendosur kur kërkesëpadinë e paditëses e ka aprovuar në tërësi si të bazuar, duke vendosur sikurse në dispozitiv të aktgjykimit të ankimuar.

Sa i përket pretendimeve ankimore për shkelje esenciale të dispozitave procedurale, ky pretendim nuk qëndron, meqë gjykata ka shqyrtuar padinë, fillimisht i ka dërguar padinë përfaqësuesit të së paditurës në përgjigje në padi, pastaj ka caktuar seancën e shqyrtimit kryesor, ka nxjerr prova të mjaftueshme, që do të thotë se gjatë vlerësimit gjykata e shkallës së parë, nuk ka bërë shkelje të dispozitave procedurale të LKA-së dhe LPK-së.

Ndërsa sa i përket pretendimeve ankimore për vërtetim të gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike, se gjykata e shkallës së parë gjatë vendosjes nuk ka marrë parasysh faktin se këshilli i ankesave i të paditurës i përbërë prej pesë ekspertëve mjekësorë të lëmive përkatëse duke vepruar sipas ankesës së paditëses pas shqyrtimit të shkresave të lëndës, pretendimeve ankimore dhe dokumentacionit mjekësorë si dhe vlerësimin e komisionit mjekësorë të shkallës së parë kishte konstatuar se paditësja nuk i plotëson kushtet për kompensim për personat paraplegjik dhe tetraplegjik. Gjykata e shkallës së parë ka aprovuar kërkesëpadinë e paditëses gjithnjë duke u bazuar në ekspertizën e eksperteve si provë të vetme pa analizuar fuqinë e saj provuese. Ekspertët mund të vërtetojnë gjendjen faktike kur është bërë ekspertiza me datë 07.12.2023 në të cilën është konstatuar se pacientja është person me aftësitë kufizuar me pasoja të përhershme dhe e paftë për tu kujdesur për veten, për lëvizje, ushqim, higjienë personale, me ikotencë permanente, mbrojtje antidekubitare dhe nevojë për terapi fizikale për ti parandalua komplikimet e tjera dhe për këto arsye grupi i ekspertëve kanë përfunduar se paditëses i takon e drejta për kompensim në grupin e parë. Fuqia provuese e nxjerrjes së provës me ekspertizë nga grupi i eksperteve të fushave të ndryshme është në kundërshtim me komisionin mjekësor po ashtu informuar nga fusha të ndryshme mjekësore dhe gjykata nuk mund ta merr si të provuar faktin për njohjen e të drejtës në kompensim për persona paraplegjik dhe tetraplegjik të grupit të parë. Këto pretendime ankimore kolegji i kësaj gjykate vlerëson se janë të pa bazuara dhe të pa qëndrueshme, meqë nga provat e administruara gjatë kësaj procedure të konfliktit administrativ është vërtetuar se paditësja i plotëson kushtet ligjore për njohjen e të drejtës së kërkuar, e në veçanti nga ekspertiza mjekësore e datës 07.12.2023 e mjekëve specialist të cilës gjykata e

shkallës së parë me të drejtë ja fali besimin në tërësi, e cila është profesionale, e argumentuar mirë sipas vëllimit të përcaktuar, për vërtetimin e fakteve vendimtare me rëndësi në këtë konflikt administrativ. Andaj gjykata e shkallës së parë me rastin e shqyrtimit të padisë së paditëses, ka nxjerrë prova të mjaftueshme të cilat vërtetojnë se pretendimet e të paditurës janë të pa bazuara dhe të pa qëndrueshme, ngase të njëjtat janë në kundërshtim me gjendjen faktike të vërtetuar nga ana e gjykatës së shkallës së parë, dhe në kundërshtim me provat në shkresat e lëndës, meqë aktgjykimi i gjykatës së shkallës së parë është në pajtim me dispozitat ligjore.

Kurse sa i përket pretendimeve ankimore se gjykata e shkallës së parë për shkak të vërtetimit të gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike, gabimisht ka aplikuar edhe të drejtën materiale, kolegji i kësaj gjykate po ashtu nuk i aprovoi, për faktin se ekspertiza mjekësore është e qartë dhe nuk kanë kontradiktë në vete, si dhe e paditura nuk ka dhënë ndonjë propozim për ndonjë ekspertizë të re. Andaj, të njëjtat janë të paqëndrueshme dhe si të tilla janë pa ndikim në vërtetimin e gjendjes tjetër faktike nga ajo e vërtetuar edhe nga gjykata e shkallës së parë. Sepse, sipas vlerësimit të kolegjit të kësaj gjykate, aktgjykimi i ankimuar i gjykatës së shkallës së parë është i qartë dhe i kuptueshëm, si dhe përmban arsye të mjaftueshme për faktet vendimtare të cilat i pranon edhe kjo gjykatë.

Duke marrë parasysh se gjykata e shkallës së parë, në mënyrë të drejtë ka zbatuar dispozitat procedurale dhe materiale me rastin e aprovimit të kërkesëpadisë së paditëses, e pasi që me pretendimet tjera ankimore një aktgjykim i tillë nuk mund të vihet në pyetje, ankesa e të paditurës u refuzua si e pa bazuar, ndërsa aktgjykimi i ankimuar u vërtetua si i drejtë dhe i ligjshëm.

Mbi këtë bazë e në mbështetje të nenit 49 të LKA-së, lidhur me nenin 200 të LPK-së, të aplikueshëm sipas nenit 63 të LKA-së, u vendos si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

GJYKATA E APELIT E KOSOVËS NË PRISHTINË

AA.nr.449/2024, me datë 08.07.2024

**Kryetari i kolegjit,
Ramiz Kuqi**